



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 30/04/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “Start Co” sh.p.k, me NUIS L11614001S dhe me adresë: Blv. "Gjergj Fishta", Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Ap.15,Tiranë

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës: REF-13306-03-12-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje eskavatori”, afati: 20 (njëzetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 11, Date 18.03.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “GERARD-A” sh.p.k, me NUIS L12407005L dhe me vlerë 11.500.000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. Shoqëria “Start Co” sh.p.k, me NUIS L11614001S dhe me vlerë 11.571.000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.
3. Shoqëria “Power Industries” shpk, me NUIS L51706022H dhe me vlerë 13.800.000 (trembëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
4. Shoqëria “AZ Trading” sh.p.k, me NUIS L81515016F dhe me vlerë 14.400.000 (katërmëdhjetë milion e katërqind mijë) lekë pa TVSH.
5. Shoqëria “Muhoplus LTD ” sh.p.k, me NUIS L52317046G dhe me vlerë 14.650.000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “GERARD-A” sh.p.k, me NUIS L12407005L.
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Nuk përmbush pikën 1/dh të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku thuhet se " 1.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: ...dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”, pasi OE ka paraqitur vërtetim debie të lëshuar nga OSHEE, më datë 06.03.2019, ku figuron i shlyer detyrimi deri në datë 31.01.2019, pa përfshirë detyrimin e maturuar të muajit shkurt.

- b) Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar, minimumi 1(një) inxhinier mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur."* pasi nuk janë paraqitur listëpagesat e 6 muajve të fundit por vetëm muaji dhjetor 2018 dhe janar 2019.
- c) Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës.* "pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- d) Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit CE të mjetit, objekt prokurimi."* pasi nuk ka paraqitur Çertifikatë Konformiteti CE.

2. "AZ Trading" sh.p.k, me NUIS L81515016F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku thuhet se *" Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjetit, të shoqëruar me foto dhe me dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe orët e punës, të shoqëruar me foto të manometrit ku regjistrohen orët e punë."* pasi katalogu i paraqitur në gjuhë të huaj është i pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se *"Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe"*.
- b) Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar, minimumi 1(një) inxhinier mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur."* pasi nuk janë paraqitur listëpagesat e 6 muajve të fundit por vetëm muajt janar-shkurt 2019.
- c) Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës.* "pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- d) Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit CE të mjetit, objekt prokurimi."* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

3. "Muhoplus LTD" sh.p.k, me NUIS L52317046G

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

- a) Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku thuhet se " *Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjetit, të shoqëruar me foto dhe me dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe orët e punës, të shoqëruar me foto të manometrit ku regjistrohen orët e punës.*" pasi katalogu i paraqitur në gjuhë të huaj është i pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se "Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe". Gjithashtu nuk janë deklaruar orët e punës dhe nuk është paraqitur foto e manometrit, ku të jenë regjistruar orët e punës.
- b) Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku thuhet se " *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat e ofruar, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga marrja në dorëzim e mallit, objekt prokurimi.*" pasi nuk ka paraqitur deklaratën e garancisë.
- c) Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku thuhet se " *Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës.*" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- d) Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet se " *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit CE të mjetit, objekt prokurimi.*" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik "Start Co" sh.p.k, me NUIS L11614001S** dhe me adresë: Blv. "Gjergj Fishta", Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Ap.15, Tiranë se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **11.571.000** (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH., është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga "5 Maji"**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **13.800.000 (trembëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 19.04.2019.

Ankesa: Nuk ka.